



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 26.05.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 19.05.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Ramë Haklaj B.I.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Ndërtimi i hapësirave publike në qendër të qytetit**“, Nr. i prokurimit- 632-23-4780-5-1-1, nxjerr:

### V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatorit ekonomik: **Ramë Haklaj B.I.**, e dt. **19.05.2023**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Ndërtimi i hapësirave publike në qendër të qytetit**“, Nr. i prokurimit- 632-23-4780-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-057-511, kundër Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë të AK –së, të datës 16.05.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË**, i publikuar me datë: **16.05.2023**;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me procedurat e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

### A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **Ramë Haklaj B.I.**, me dt. **19.05.2023**, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Ndërtimi i hapësirave publike në qendër të qytetit**“, Nr. i prokurimit- 632-23-4780-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-057-511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 26.05.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

- Pretendimi juaj se është diskriminuese që të kërkohet që inxhinierët dhe punëtorët tjerë të jenë të pajisur me certifikata për siguri dhe shëndet ne pune, është i pabazuar sepse qëllimi i kësaj kërkesë është: përcaktimi i masave për përmirësimin e shkallës së sigurisë dhe shëndetit të të punësuarve në punë, duke u bazuar në LIGJI NR. 04/L-161 PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË, pra operatori apo grupi i operatorëve duhet të kenë staf të pajisur me këto certifikata;
- Pretendimi juaj se është diskriminuese që të kërkohet certifikatë për menaxhim dhe organizim të kantierit është i pabazuar sepse kërkesat për certifikatë të menaxhim dhe organizim të kantierit – janë kërkesa për stafin menaxhues për inxhinierët, ku kjo certifikatë tregon po ashtu përvojën e kërkuar dhe tregon trajnimet shtesë sepse përvoja e kërkuar për stafin profesional është e domosdoshme për shkak të madhësisë dhe rëndësisë të këtij projekti;
- Lidhur me pretendimin tuaj për ing.gjeodezisë sqarojmë se inxhinieri i diplomuar i gjeodezisë është i barasvlershëm me master të gjeodezisë, pra pranohen të dy titujt.
- Pretendimi juaj lidhur me kërkesat e AK, për makineritë është i pabazuar, sepse Autoriteti kontraktues nuk ka vendosur limit fiks për paisje dhe është Autoriteti kontraktues ai që vendos kriteret dhe specifikat që mendon se janë të domosdoshme për kryerjen me sukses të një aktiviteti.  
Autoriteti kontraktues ka kërkuar pajisje që janë të nevojshme për realizimin e projektit, kurse ju nuk keni dhënë argumentet të mjaftueshme se pse nuk duhet të jenë pjesë e listës makierit në të cilat jeni ankuar, kryesisht jeni ankuar se është makineri e rrallë.
- Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së, sepse ka kërkuar që automjetet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit me afat valid, shkelje do të ishte po të mos kërkohej një gjë e tillë.
- Kërkesa për Lead Auditor dhe iso standardet, është e bazuar në certifikata të cilat lëshohen nga institucione përkatëse, me të cilat pajisen stafi i OE apo ndonjë subjekti tjetër, prandaj edhe ky pretendim i juaji është i pabazuar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

  
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;